



Drejtoria Komunale e Arsimit  
Odeljenje za Obrazovanje  
Department of Education

**Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të Vitit  
Shkollor 2024/2025**



Të nderuar!

Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë periudhës së gjysmëvjetorit të parë është angazhuar për përcjelljen e mbarëvajtjes së procesit edukativo arsimor.

Ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht në kontakt të përhershëm dhe në vizita në shkolla dhe sipas të gjitha të dhënave, procesi mësimor i gjysmëvjetorit të parë pati filluar në të gjitha shkollat, sipas kalendarit vjetor të MASHTI-t dhe u zhvillua normalisht.

Gjatë kësaj periudhe kemi kryer disa punë dhe kemi zhvilluar disa aktivitete, të cilat në mënyrë kronologjike po i paraqesim siç vijon:

- ❖ Më 2 shtator 2024 filloi viti i ri shkollor në të gjitha shkollat e komunës sonë, me ç'rast vizitua 2 shkolla dhe po atë ditë përruam projektin e riparimeve të brendshme në objektin e shkollës "Skënder Kastrioti" paralelja e ndarë fizike në Gexhë;
- ❖ Në kuadër të projektit të riparimeve në shkolla, janë zhvilluar punime në rregullimin e furnizimit me rrymë për pajisjet e kuzhinës në çerdhen e Xërxës; Këto punime kanë ndodhur edhe në 2 çerdhet tjera;
- ❖ Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti, kemi ndërhyrë në ndarjen e disa klasave në objektin e SHFMU "Faik Konica" dhe në përshtatjen e këtij objekti për të mbajtur mësim në një ndërrim për të gjithë nxënësit e kësaj shkolle;
- ❖ Në shkollat e reja në ndërtim, në Pastasel, në Xërxë dhe Ratkoc, kanë vazhduar punimet. Në Xërxë ka vazhduar ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike, përbri objektit të vjetër të shkollës; Punime ka pasur edhe në ndërtimin e Çerdhes në Lagjen e Epërme në qytet;
- ❖ Kemi mbajtur një takim të përbashkët me Kolegjiumin për Arsim të AKK dhe Komisionit Parlamentar për Arsim Profesional, ku diskutuam për plotësim ndryshimet e Ligjit për Arsim Profesional;
- ❖ Morëm pëlqimet nga MASHTI për themelimin e 3 çerdheve të reja si institucione të reja edukativo-arsimore;

- ❖ DKA, së bashku me DKRS dhe me Forumin Anadrini, mbajtëm Garën Komunale të Poezisë të vlefshme për çmimin Xhevdet Bajraj, e cila u mbajt më 11 tetor 2024, ku u shpallën edhe 3 fituesit e këtij çmimi;
- ❖ Ka filluar gjatë muajit tetor dhe është bërë furnizimi i plotë i të gjitha institucioneve edukativo-arsimore me lëndë për ngrohje për periudhën e dimrit;
- ❖ Së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe me Drejtorinë e Administratës, nënshkruam marrëveshje me IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici" për zhvillimin e praktikës profesionale për nxënësit e kësaj shkolle;
- ❖ Propozim vendimet për themelimin e 3 çerdheve të reja si institucione të reja edukative në fëmijërinë e hershme, i paraqitëm për miratim në mbledhjen e KPF dhe i vendosëm si pika për miratim në mbledhjen e Kuvendit;
- ❖ Janë mbajtur ligjërata vetëdijësuese nga Policia në disa prej shkollave të komunës, të parapara në planin operativ;
- ❖ Shkollat fillore dhe të mesme të larta nga 30 tetori deri më 4 nëntor, ishin në pushimin vjeshtor të paraparë në kalendarin vjetor, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe në Shkollën "Isa Boletin" është zhvilluar trajnimi për kurrikulë i dy grupeve të mësimdhënësve të rinj;
- ❖ Më 9 nëntor, 2024 u mbajt Gara Komunale e Olimpiadës së Matematikës, në të cilën morën pjesë nxënësit më të mirë të matematikës të klasave 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12, nga të gjitha shkollat e komunës sonë;
- ❖ Më 16 nëntor 2024, u mbajt Gara Republikane e Olimpiadës së Matematikës, në të cilën i dërguam 13 nxënësit më të mirë të matematikës të klasave 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12, nga të gjitha shkollat e komunës sonë;
- ❖ Kemi furnizuar me ushqime të nevojshme 3 çerdhet e reja të fëmijëve dhe kemi bërë përgatitjet e duhura për të filluar të punojnë me orar të plotë, nga ora 8:00 deri në orën 16:00;
- ❖ Me rastin e Festës së 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit, në shumicën e shkollave të komunës sonë, e po ashtu edhe në çerdhet, janë zhvilluar dhe mbajtur aktivitete festive;
- ❖ Kemi vazhduar përgatitjet për fillimin e mbajtjes së Garave Shkollore, të vlefshme për Garën Komunale dhe Shtetërore të Fizikës;
- ❖ Mbajtëm takimin e fundit për fundvitin 2024 me drejtorët e shkollave, me koordinatorët e cilësisë dhe me kryetarët e KDSH-ve të shkollave.

Gjatë kësaj periudhe u përballëm me disa sfida dhe vështirësi, të cilat shkaktuan probleme në mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor në shkolla.

Sfidat kryesore, ishin:

1. **Mungesat e mësimdhënësve nga lëndët deficitare, sidomos në lëndën e matematikës;**  
Ka pasur raste kur dy herë na ka dështuar konkursi për lëndën e matematikës për shkak se nuk ka pasur kandidatë/e të paraqitur/a dhe jemi detyruar ta rishpallim konkursin, ndërkohë që orët mësimore kanë humbur.
2. **Funksionalizimi i plotë i çerdheve, për shkak të mospërshtatjes së pajisjeve të kuzhinave të 3 çerdheve të reja me tensionin adekuat të rrymës elektrike me këto**

**pajisje; U deshën 3 muaj kohë për të investuar në instalimet shtesë të rrymës elektrike, në mënyrë që ato të funksionalizohen plotësisht;**

### **3. Mungesat e mësimdhënësve për shkak të sëmundjeve të ndryshme dhe shkuarjet e pa planifikuara jashtë vendit të disa mësimdhënësve;**

Gjatë kësaj periudhe, nga 2 shtatori 2024 e deri më 24 dhjetor 2024, janë evidentuar këto mungesa:

Mungesat e mësimdhënësve nga SHFMU-të

Pa arsye: 43

Mungesat e mësimdhënësve nga SHML-të

Pa arsye: 64

Për mungesat e pa arsyeshme, DKA ka aplikuar ndalesa në pagë për secilin që ka bërë mungesa të tilla.

### **4. Mungesat e nxënësve, sidomos të atyre të Shkollave të Mesme të Larta**

Mungesat e nxënësve në SHFMU-të

**Pa arsye: 19306**

E shprehur në përpjestim me numrin e nxënësve, që është **5872**, i bie që secili nxënës ka bërë mesatarisht nga **3.28** mungesa të pa arsyeshme

Mungesat e nxënësve në SHML-të dhe në IAAP

**Pa arsye: 14158**

E shprehur në përpjestim me numrin e nxënësve,, që është 1063, i bie që secili nxënës ka bërë mesatarisht nga **13.3** mungesa të pa arsyeshme, domethënë secili prej tyre ka humbur mesatarisht nga **13 orë** mësimore gjatë gjysmëvjetorit të parë. Nxënësit që kanë bërë më shumë se 32 mungesa të pa arsyeshme janë transferuar në shkolla të tjera, brenda dhe jashtë komunës, në përputhje me udhëzimet administrative.

## 5. Organizimi i mësimit joformal për të rritur

Mësimi joformal në IAAP "Selajdin Mullabazi-Mici" i cili ka filluar të funksionalizohet si proces vitin që shkoi, ka rezultuar me 14 kandidatë, të cilët me sukses e kanë mbaruar klasën e dhjetë. Në këtë proces, bazuar në raportin e bashkëngjitur të drejtorisë së IAAP-së, janë përfshirë 20 mësimdhënës, sipas lëndëve dhe profileve të ndryshme.

Procesi mësimor i vlefshëm për gjysmëvjetorin e parë, përfundoi më 24 dhjetor 2024 dhe gjysmëvjetori i dytë filloi më 8 janar 2025.

**Datë: 25.2.2025**



**Avni Morina, Drejtor i DKA-së**

*Avni Morina*